



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Ministria e Mbrojtjes**  
**Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve**

**URDHËR**

Nr. 3996 datë 02/10 2019

**PËR**

**“PLOTËSIMIN E FORMULARIT BASHKËNGJITUR PËR DORËZIMIN E KËRKESAVE/DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM NGA ANA E SUBJEKTEVE”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, si dhe të pikës 2, të Kreut IV, të VKM nr. 43, datë 16.01.2008 “Për organizimin funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”, si dhe Rregullores së AKSHE-së nr. 2834, datë 16.10.2019 me qëllim caktimin e një praktike tip e cila do të lehtësojë procedurën e dorëzimit të kërkesave / dokumentacionit për pajisje me çertifikata / licensa / autorizime / të tjera, nga ana e subjekteve aplikuese pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve:

**URDHËROJ**

1. Plotësimin e “Formularit për të dhënat e kontaktit”, formular i cili do ti bashkëlidhet kërkesës për aplikim të subjektit aplikues në momentin e dorëzimit të dosjes së dokumentacionit pranë AKSHE.
2. Dokumentacioni i paraqitur, duhet të jetë i listuar dhe numërtuar nëpërmjet një liste dokumentesh, vendosur në krye të dosjes.
3. Subjekti në momentin e paraqitjes së kërkesës për aplikim dhe dorëzimit të dokumentacionit, pranë Sekretarisë së Institucionit, ku Sekretari nëse vëren se kërkesa nuk është shoqëruar me Formularin për të dhënat e kontaktit, si dhe listën e numërtuar të dokumenteve në krye, ka të drejtë të vendosë kthimin e akteve subjektit aplikues.
4. Subjektet e interesuara për të marrë informacione të mëtejshme do të priten nga një person i caktuar, punonjës i AKSHE-së, në ambjentin e pritjes, si dhe do të ndalohet rreptësisht qarkullimi i personave të jashtëm ta paautorizuar, në ambjentet e AKSHE -së.
5. Urdhërohen punonjësit e caktuar për pranimin e kërkesave për aplikim dhe pritje, për zbatimin e këtij Urdhri.
6. Ky urdhër së bashku me Formularin për të dhënat e kontaktit do të publikohet në faqen zyrtare të AKSHE-së [www.akshe.gov.al](http://www.akshe.gov.al)

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**  
**Engjëllush BEKTESHI**

